



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 18 të Udhëzimit administrativ nr. 06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, nenit 13 të Udhëzimit administrativ (MPL) nr. 03/2020, për transparencë në komuna, nenit 32, pika **c** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 29.06.2022, merr këtë

V E N D I M

PËR KONSULTA PARAPRAKE PUBLIKE LIDHUR ME PROJEKTRREGULLOREN PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE ME TAKSI

I.

MIRATOHET Vendimi për lënie në konsultim publik të Projektregullorës për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi.

II.

Lidhur me Projektregulloren e cekur në pikën I, komisioni do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar, përmes formave të fushatave informative, kontakteve me grupe të interesit dhe palët e interesuara për t'i diskutuar propozimet.

III.

Konsultat paraprake publike për projektregulloren e cekur në pikën I të këtij vendimi, do të zgjasin 30 ditë.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit dhe drejtoritë tjera kompetente.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-346/06-151655/22, më 30.06.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Klupina

